




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË EKONOMISË PËR VITIN 2024

Prishtinë, maj 2025

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Ekonomisë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Ekonomisë (ME), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Ekonomisë, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

## Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Ministria e Ekonomisë gjatë vitit 2024 kishte paguar/shpenzuar nga kategoritë ekonomike jo adekuate vlerën prej 417,162€;
- B1 Pasuritë në regjistra të pasurive dhe në PFV ishin të mbivlerësuara për 316,428€, pasi që Ministria nuk kishte arritur t'i regjistroj të gjitha pasuritë sipas kërkesave të rregullores për menaxhimin e pasurive; dhe
- A2 Detyrimet kontingjente ishin të nënvlerësuara në PFV në vlerën prej 91,375€ pasi që Ministria nuk kishte evidentuar vlerën e saktë të tyre.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të ME kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

## Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

## Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministrja është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Ekonomisë.

## Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Ekonomisë është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Ekonomisë në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

## Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Ekonomisë me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Ekonomisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Fushat kryesore që kërkojnë më tepër fokus përfshijnë klasifikimin e saktë të shpenzimeve nëpër kategori ekonomike përkatëse, evidentimin e pasurive dhe menaxhimin e tyre në përputhje me rregullat e përcaktuara dhe mbajtja e saktë dhe azhurnimin e regjistrave të detyrimeve kontingjente bazuar në informatat rreth ngjarjeve kontestimore. Po ashtu, fokus i veçantë duhet t'i kushtohet efektivitetit të proceseve të prokurimit dhe auditimit të brendshëm.

Ky raport ka rezultuar me pesë rekomandime, prej tyre katër janë rekomandime të reja, dhe një i përsëritur. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

### 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

#### Çështja A1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

##### Gjetja

Sipas nenit 18, pika 3 të Rregullës financiare nr. 01/2013 - Shpenzimi i parave publike, shpenzimet duhet të jenë të regjistruara në kode adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, te shtojca 1 e Udhëzimit Administrativ nr. 04/2019 për Definimin e Projekteve Kapitale dhe Klasifikimin e Shpenzimeve të Projekteve Kapitale, theksohet se pas vënies së një asemi në përdorim për herë të parë, çdo shpenzim i mëtejshëm operativ konsiderohet si shpenzim rrjedhës.

Në vitin 2024, ME bazuar në planifikimin buxhetor, ka paguar shpenzime në vlerë 417,162€ nga kategoritë ekonomike jo adekuate. Shpenzimet nga kategoritë jo adekuate ishin si në vijim

- Projekti kapital "Ekonomia dixhitale e Kosovës - KODE", për instalimin e rrjetit të brendshëm, pajisjeve dhe lidhjes së internetit nëpër shkolla kishte të përfshirë edhe shërbimin e internetit për një periudhë pesë (5) vjeçare. Nga testimi i gjashtë (6) pagesave në vlerë prej 1,414,262€, rezultoi se vlera prej 411,433€ ishte për shërbime të internetit e që ishin paguar nga investimet kapitale. Shërbimet e internetit edhe për nga natyra por edhe sipas planit kontabël i takojnë kategorisë së mallrave dhe shërbimeve; dhe
- Furnizimi me aparat fotografik në vlerë prej 5,729€ ishte paguar nga kategoria mallra dhe shërbime edhe pse për nga vlera (mbi 1,000€) sipas rregullave ky shpenzim i takon kategorisë investime kapitale.

Bazuar në informacionet e marra nga Udhëheqësi i Projektit i cili ishte përgjegjës i projektit ndarja e shpenzimeve të projektit do të shkaktonte vështirësi në funksionalitetin e shërbimeve të internetit nëpër shkolla. Megjithatë, ne vlerësojmë se shkak i ishte se në fazën e planifikimit të

projektit nuk ishte analizuar mjaftueshëm se cilat shpenzime të projektit mund të kapitalizohen e cilat janë shpenzime operative.

**Ndikimi** Raportimi apo klasifikimi jo i saktë i të dhënave në pasqyrat financiare reflekton në keqkuptim të aktiviteteve financiare të Ministrisë, duke rezultuar në mbivlerësim / nënvlerësim të kategorive ekonomike përkatëse.

**Rekomandimi A1** Ministrja duhet të siguroj që janë ndërmarrë veprime konkrete në koordinim edhe me Ministrinë e Financave në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit dhe që pagesa dhe regjistrimi i tyre të bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

#### Çështja B1 - Mangësi në regjistrimin e pasurive

**Gjetja** Sipas nenit 6, pikës 3 të Rregullores MF - nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare, pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria". Kurse neni 5 i të njëjtës rregullore e përcakton klasifikimin që duhet aplikuar për regjistrimin e pasurive.

Nga testimet dhe analizat e regjistrimit të pasurive, identifikua se pasuritë në PFV-të e Ministrisë ishin mbivlerësuar për 316,428€.

Informatat detaje mund të shihen si në vijim:

- Pajisje të teknologjisë informative në vlerë neto prej 136,761€ të paguara nga kategoria e investimeve kapitale, nuk ishin evidentuar në regjistrin e pasurive. Kjo rrjedh nga fakti që nga pagesat për pajisje të TI-së në vlerë 1,068,266€ të realizuara nga investimet kapitale, vetëm pjesa prej 610,775€ ishte regjistruar si pasuri në sistemin e-pasuria, kurse pjesa tjetër prej 320,730€ kishte të bënte me shpenzime të internetit që nuk ishin pasuri dhe zhvlerësimi i akumuluar; dhe
- Në anën tjetër pajisje të TI-së në vlerë prej 1,445,366€, ishin regjistruar gabimisht në klasën e pasurive si "investime në vijim", edhe pse ishte kryer pranimi teknik dhe ato kishin hyrë në funksion. Për më tepër, këto pasuri ishin regjistruar duke përfshirë edhe shpenzimet operative për shërbimin e internetit. Vlera neto e tyre në fund të vitit ishte 992,177€, që rezultoi me një mbivlerësim prej 453,189€.

Dobësitë në regjistrin kontabël të pasurive kanë ndodhur për shkak të mos funksionimit adekuat të kontroleve të brendshme, për sa i përket fushës së pasurisë.

**Ndikimi** Mungesa e regjistrave të saktë dhe të plotë të pasurive dhe raportimi jo i duhur i tyre pamundëson një menaxhim dhe kontroll efektiv mbi pasuritë. Si rrjedhojë e këtyre mangësive kemi nënvlerësim të pasurive duke rezultuar edhe në prezantimin jo të drejtë të tyre në pasqyra financiare.

**Rekomandimi B1** Ministrja duhet të siguroj regjistrimin e plotë dhe të saktë të pasurisë si dhe azhurnimin e regjistrave me qëllim që shpalosjet në PFV të jenë të sakta

dhe të prezantojnë pamje të drejtë. Po ashtu, duhet shtuar kujdesi gjatë procesit të regjistrimit të pasurive dhe gabimet e evidentuara në regjistrin e pasurive duhet të korrigjohen në mënyrë që vlera e pasurive të jetë reale.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja A2 - Mangësi në prezantimin e detyrimeve kontingjente**

- Gjetja** Bazuar në Rregulloren MF nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore (OB) të mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jofinanciare. Sipas nenit 18 të kësaj rregullore OB duhet të raportojnë të gjitha detyrimet kontingjente. Ne identifikuar se Ministria kishte bërë shpalosjen e detyrimeve kontingjente në PFV por që kjo vlerë nuk ishte e saktë, pasi që ishte e nënvlerësuar për 91,375€. Një padi e raportuar në PFV në vlerë prej 5,000€, bazuar në dokumentacionin e siguruar nga data baza e gjykatave rezulton të jetë në vlerë prej 96,375€. Duhet theksuar se as Avokatura Shtetërore nuk e kishte informuar Ministrinë e Ekonomisë rreth aktvendimit të fundit të Gjykatës për këtë lëndë.
- Kontrollet e brendshme jo efektive dhe mos informimi nga avokatura shtetërore rreth aktvendimeve të reja të gjykatave ka shkaktuar këtë mangësi në prezantimin jo të drejtë të detyrimeve kontingjente.
- Ndikimi** Prezantimi jo i plotë i detyrimeve kontingjente ndikon që PFV-të të mos prezantojnë gjendjen e drejtë dhe vlera e tyre financiare të nënvlerësohet.
- Rekomandimi A2** Ministrja duhet të siguroj një kontroll dhe koordinim më efektiv në mes zyrës ligjore dhe avokaturës shtetërore me qëllim që regjistrat e detyrimeve kontingjente të mbahen të saktë dhe të azhurnuar me informata, dhe që shënimet në PFV të prezantohen të sakta.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.2.1 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 16,747,761€, prej tyre në 2024 ishin shpenzuar 5,235,623€. Ato kanë të bëjnë me blerjen e pajisjeve të teknologjisë informative, si dhe zbatimin e masave për efikasitet në ndërtesat publike.

#### Çështja A3 - Vonesa në procesin e vlerësimit të tenderëve

##### Gjetja

Sipas nenit 40.3 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, si dhe nxjerrja e njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, duhet të kryhet brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore, por jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të arsyetuara, veçanërisht për kontrata komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh. Procesi i vlerësimit të tenderit duhet të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve.

Në procedurën e prokurimit “Implementimi i Rrjetit të Pavarur Jopublik 5G në Parkun e Inovacionit dhe Trajnimit në Prizren”, vlerësimi i ofertave është kryer 73 ditë pas hapjes së ofertave, ndërsa themelimi i komisionit është bërë 18 ditë pas hapjes së ofertave.

Procesi i themelimit të komisionit të vlerësimit ishte vonuar për shkak që Ministria kishte kërkuar të angazhoj dy anëtar në vlerësim të ofertave nga Institucionet tjera, përderisa vlerësimi i ofertave ka zgjatur për shkak të natyrës specifike të procedurës, e cila lidhet me përdorimin e teknologjisë së re inovative 5G. Për të siguruar një vlerësim të detajuar dhe të besueshëm, ka qenë e nevojshme të kryhen hulumtime shtesë dhe të përfshihet një ekspertizë më e thelluar.

##### Ndikimi

Vonesat në vlerësim të tenderëve përveç anashkalimit të rregullave kanë ndikuar në vonesat në lidhje të kontratës e rrjedhimisht edhe në realizim të projektit.

##### Rekomandimi A3

Ministrja duhet të siguroj që themelimi i komisionit të vlerësimit të ofertave të bëhet me kohë, në mënyrë që procesi i vlerësimit të përfundojë brenda afateve të përcaktuara. Në rastet kur bëhet fjalë për procedura komplekse, duhet të shtohen resurset e nevojshme për të përshpejtuar procesin e vlerësimit dhe për të shmangur vonesat në nënshkrim të kontratave.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.2.2 Funkzioni i auditimit të brendshëm

### Çështja A4 - Mos përmbushja e planit vjetor të auditimit të brendshëm

<b>Gjetja</b>	<p>Sipas nenit 17 të Ligjit Nr. 06/L-021 për Funkcionimin e Auditimit të Brendshëm, auditimi i brendshëm ofron siguri të pavarur dhe objektive për udhëheqësin e subjektit të sektorit publik lidhur me përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe ofron këshilla për përmirësimin e tij. Për të përmbushur këtë funksion, Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) duhet të zbatojë planin vjetor të auditimit të miratuar.</p> <p>Njësia e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Ekonomisë (ME) nuk kishte arritur as përafërsisht ta realizonte planin vjetor të auditimit për vitin 2024. Nga pesë auditime të planifikuara, ishte përfunduar vetëm një auditim në korrik 2024, i cili kishte përfshirë Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.</p> <p>Plani vjetor i auditimit dhe plani strategjik 2024-2026 ishin miratuar në fund të dhjetorit 2023. Në fillim të vitit (më 4 janar 2024) Njësia Qëndrore Harmonizuese (NJQH-AB) kishte kërkuar një harmonizim më të mirë midis planit strategjik dhe atij vjetor. Këto çështje ishin adresuar nga ana e NJAB-së dhe si rezultat i kësaj Komiteti i Auditimit në muajin prill kishte rekomanduar NJAB-në që të vazhdonte me përmbushjen e auditimeve pa pasur nevojë për ri-miratim të Planit vjetor duke konsideruar që rekomandimet e NJQH-AB ishin teknike dhe nuk ishin pengesë për realizimin e auditimeve të planifikuara.</p> <p>Përmbushja e planit të auditimit në nivel të ulët sipas NJAB-së ishte shkaktuar nga vonesat në adresimin e çështjeve të kërkuara për përmirësim nga monitorimi i NJQH-AB. Ne vlerësojmë se monitorimi nga NJQH-AB ishte përdorur si arsytim i panevojshëm dhe pengesë në përmbushjen e auditimeve të planifikuara nga ana e NJAB-së.</p>
<b>Ndikimi</b>	Niveli shumë i ulët i përmbushjes së planit vjetor të auditimit ndikon në mos identifikimin apo parandalimin e parregullsive nga aktivitetet operacionale të Organizatës por edhe në funksionimin efektiv të kontrollit të brendshëm.
<b>Rekomandimi A4</b>	Ministrja duhet të siguroj se NJAB vepron në mënyrë efektive, në mënyrë që t'i shtoj vlerë përmirësimit të aktiviteteve operative dhe cilësisë së kontrolleve të brendshme aktuale. Po ashtu, duhet të përmbushen objektivat duke mbuluar fushat e përcaktuara në planin vjetor të auditimit.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>5</sup>	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>58,627,892</b>	<b>77,018,362</b>	<b>56,042,182</b>	<b>57,655,068</b>	<b>178,300,277</b>
Grante Qeveritare - Buxheti	35,636,314	53,976,784	48,746,662	51,933,772	173,399,369
Financimi përmes huamarrjes	10,339,564	10,389,564	4,370,793	5,577,011	3,476,681
Financimi përmes huamarrjes - klauzola e investimeve	12,652,014	12,652,014	2,924,726	144,285	1,424,226


Buxheti final në raport me buxhetin fillestar është rritur për 18,390,470€. Ky ndryshim vjen si rezultat i ndarjeve buxhetore me vendime të Qeverisë në fushën subvencione dhe transfere për mbështetje në tejkalimin e krizës energjetike, përkatësisht për zbatimin e masës 4 dhe 5 të Planit të Veprimit për zbutjen e ndikimit të menjëhershëm socio-ekonomik të krizës energjetike, si dhe mbështetje për ndërmarrjet publike.

Në vitin 2024 ME ka shpenzuar 56,042,182€ apo 73% të buxhetit final, derisa në vitin paraprak, niveli i realizimit ishte 64%.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>58,627,892</b>	<b>77,018,362</b>	<b>56,042,182</b>	<b>57,655,068</b>	<b>178,300,277</b>
Pagat dhe mëditjet	1,592,647	1,476,439	1,476,439	1,383,381	1,142,374
Mallrat dhe shërbimet	9,132,986	8,315,628	3,106,150	2,012,538	1,558,983
Komunalitë	23,130	18,793	16,875	13,342	11,333
Subvencionet dhe transferet	29,920,448	50,459,741	46,207,094	50,990,756	171,491,629
Investimet Kapitale	17,958,681	16,747,761	5,235,623	3,255,051	4,095,958

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 116,208€ me vendim të Qeverisë për kursime buxhetore. Shpenzimi për këtë kategori ishte 100%.

Buxheti final për mallra dhe shërbime në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 817,358€. Kjo si rezultat i vendimeve të Qeverisë për kursime buxhetore. Shuma e shpenzimeve të realizuara në këtë kategori është vetëm 37%. Kjo përqindje ishte pasojë e progresit të ulët financiar lidhur me shpenzimin nga fondi i huamarrjes për projektet të financuara nga klauzola e investimeve.

Buxheti final për shpenzime komunale në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 4,337€ me vendim të Qeverisë për kursime buxhetore. Shpenzimi për këtë kategori ishte 90%.

Buxheti final për subvencione dhe transfere në raport me buxhetin fillestar është rritur për 20,539,293€. Kjo rritje ishte rezultat i ndarjeve buxhetore me vendime të Qeverisë për zbatimin e masës 4 dhe 5 të Planit të veprimit për zbutjen e ndikimit të menjëhershëm socio-ekonomik dhe për zbatimin e masës 4.6 - mbështetje për ndërmarrjet publike. Shpenzimi për këtë kategori ishte rreth 92%.

Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 1,210,920€ si rezultat i rregullimeve të brendshme dhe deklarimeve për kursim. Përkundër këtij zvogëlimi vetëm 31% e buxhetit ishte shpenzuar gjatë vitit 2024. Ky nivel i ulët i realizimit ishte si rezultat i planifikimit të dobët të NP-ve të cilat kanë qenë bartëse të planifikimit dhe të realizimit të projekteve të financuara nga klauzola e investimeve për projektet si ne vijim: Impianti për ujëra të zeza ne Komunën e Prishtinës, financimi i planifikuar, Projekti i zhvillimit të ujerave të zeza në Gjilan dhe Ndërtimi i Impiantit për Trajtimin e Ujerave në Gjilan, si dhe Projekti i Trajtimin të Ujerave të Zeza Mitrovicë.

Sa i përket ndarjeve për “Programin e ringjalljes ekonomike”, nga kodi i projektit (00098) në kategorinë subvencione dhe transfere janë ndarë 10,639,293€ për zbatimin e masës 4.6 - mbështetje për ndërmarrjet publike. Shpenzuar nga ky kod ishin 10,111,045€.

Të hyrat e realizuara nga ME në 2024 ishin në vlerë 128,179€. Ndërsa pjesa tjetër, prej 16,348,846€, ka të bëjë me kthimin e mjeteve financiare të pashfrytëzuara nga subvencionimi për vitet 2022 dhe 2023 nga KEK Sh.A.

**Tabela 3. Të hyrat (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>49,279</b>	<b>49,279</b>	<b>16,477,025</b>	<b>121,161</b>	<b>1,113</b>
Të hyrat jo tatimore	49,279	49,279	128,179	117,896	1,113
Të hyrat tjera	0	0	16,348,846	3,265	

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2023 të ME-së ka rezultuar në katër rekomandime. ME kishin përgatitur Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatojnë rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, tre rekomandime janë zbatuar dhe një nuk është zbatuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Ministrja përmes personave përgjegjës të sigurojë se komisionet vlerësuese përfillin të gjitha kriteret e kërkuara me dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë, dhe se vendimi për dhënie të kontratës bëhet vetëm pas marrjes së sigurisë së të gjitha kërkesat janë përmbushur.	Nuk kemi hasur në raste të tilla.	I zbatuar
2.	Baza për konkluzion	Ministrja të sigurojë se KRPP njoftohet përmes platformës së prokurimit publik brenda 2 ditëve nga data e marrjes së vendimit që të përdoret procedura e negociuar pa publikim të njoftimit. Po ashtu, të sigurojë se çdo ndryshim në kushtet e kontratës para ose gjatë periudhës së zbatimit do të bëhet vetëm pas njoftimit dhe marrjes së aprovimit nga ZKA. Zhvillimi i procedurave duhet të bëhet në përputhje me rregullat e prokurimit publik.	Nuk kemi hasur në raste të tilla.	I zbatuar
3.	Pasuritë	Ministrja duhet të siguroj regjistrimin e plotë dhe të saktë të pasurisë si dhe azhurnimin e regjistrave me qëllim që shpalosjet në PFV të jenë të sakta dhe të prezantojnë pamje të drejtë. Po ashtu, duhet të bëhet vlerësimi i pasurive me vlerë zero e të cilat janë ende në përdorim me qëllim të pasqyrit të gjendjes së saktë dhe të drejtë në regjistrat e pasurive të ministrisë.	Gjatë këtij viti kemi hasur në pasuri të paregjistruara.	Nuk ka filluar zbatimin
4.	Pasuritë	Ministrja duhet të siguroj se procesi i inventarizimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, si dhe pasi të jetë hartuar një raport i përgjithshëm mbi inventarizimin e pasurisë, të krahasohet gjendja e inventarizimit me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare për të korrigjuar gabimet e mundshme. Raporti duhet të përfshijë rekomandime të qarta të cilat do të jenë bazë për punën e komisionit të vlerësimit të pasurisë. I gjithë ky proces duhet të përfundoj para përgatitjes së PFV për vitin 2024. Po ashtu, duhet të bëhet vlerësimi i pasurive me vlerë zero e të cilat janë ende në përdorim me qëllim të pasqyrit të gjendjes së saktë dhe të drejtë në regjistrat e pasurive të ministrisë.	Janë marrë veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij rekomandimi.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Faruk Rrahmani, Drejtor i Auditimit



Alban Beka, Udhëheqës i ekipit



Flora Berisha, Anëtare e ekipit



Veton Misiri, Anëtar i ekipit



Arnisa Aliu, Anëtare e ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi

	
<p>Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo Qeveria-Vlada-Government Ministria e Ekonomisë Ministarstvo Ekonomije /Ministry of Economy</p>	
<p>LETËR E KONFIRMIMIT</p> <p>Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve</p>	
<p>Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit</p> <p>Të nderuar,</p> <p>Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të <b>Ministritë së Ekonomisë</b>, për vitin 2024 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");</li><li>• pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;</li><li>• brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.</li></ul>	
<p>Artane Rizvanolli, Ministre e Ekonomisë në Detyrë,</p> <p>Data: 02.05.2025 Prishtinë, </p> 	

## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>6</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>7</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

### Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

### Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>6</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>7</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.